



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 931

Datë: 1 / 4 / 2026

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në dispozitat e nenit 14 të Statutit të UP-së, si dhe në dispozitat e nenit 19, nenit 28, nënpike 1.2, të Rregullores së punës nr. 280 të datës 13.2.2025, në mbledhjen e mbajtur më 26.03.2026, mori vendim të shpallë:

### KONKURS

**Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (baçelor), për të arriturat e vitit akademik 2024/25**

#### I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursat universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve themelore (baçelor).
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të Universitetit të Prishtinës;
  - 2.2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lart;
  - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
  - 2.4. Të kenë të regjistruar semestrat për vitin akademik 2025/26;
  - 2.5. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2024/25;
  - 2.6. Të kenë notë mesatare së paku 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Përjashtimisht nga pika 2.6, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë, të Fakultetit të Arkitekturës, të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikes, mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, por jo më pak se 8 (tetë).
4. Studentëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme, shërbimi i studentëve në njësinë akademike përkatëse nuk do t'ua verifikojë në SEMS fletëparaqitjen, e cila ua mundëson aplikimin për bursë.
5. Studentët të cilët në vitin akademik 2024/25 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare në vitin akademik 2025/26.

## II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet të bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: [sems.uni-pr.edu](https://sems.uni-pr.edu)
2. **Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:**
  - 2.1 Kërkesa për aplikim (fletë aplikacioni), e cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS-it.
3. Studenti obligohet që fletë aplikacionin ta printojë dhe ta dorëzojë në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakultetet janë të obliguara që, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë konkurs, t'i përgatisin listat e studentëve, të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësisve akademike.
6. Bursat universitare në vitin akademik 2025/26, për rezultatet e arritura në vitin akademik 2024/25, do t'u ndahen studentëve të nivelit baçelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues të UP-së.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, studentët duhet të paraqesin kërkesë për ndihmë në SEMS, te pjesa Kërkesa/Ankesa, duke përshkruar problemin që u shfaqet.

## III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun: [sems.uni-pr.edu](https://sems.uni-pr.edu) hapet prej datës **02.04.2026 deri me datë 10.04.2026, në orën 16:00.**

## IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18), në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

## V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe faqet zyrtare të fakulteteve, si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës: [www.uni-pr.edu](https://www.uni-pr.edu).

